

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

TRANSGLOBAL RENTALS SHPK

Sot me date 05.10.2023 ortaku i vetem themelues:

Elisa Hoxhaj , e bija e Muratit lindur në Zogaj, Tropojë me 01.09.1992, banues në Rruga Jordan Misja, Nd.170;H.29;Ap.34; Njesia Administrative Nr.9, 1016;Tiranë, madhore dhe me zotesi te plote juridike,mbajtes i kartes se identitetit me nr. O36884962 dhe numur personal J25901038A.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901,date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” dhe Ligjin Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe ne Legjislacionin shqiptar në fuqi. vendosi të krijojë Shoqerinë me pergjegjesi te kufizuar **TRANSGLOBAL RENTALS SHPK** dhe për këtë qëllim harton harton këtë akt-themelimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Emri

Emri i shoqerise të emertohet **TRANSGLOBAL RENTALS SHPK**, krijuar nga ortaku i vetem i shoqerise percaktuar ne statutin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi.

Neni 2

Forma

Shoqeria eshte krijuar si person juridik dhe fiton pesonalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtare prane Qendres Kombetare te Regjistrimit(QKB).

Shoqeria zhvillon veprimtarine ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj,Statutin dhe Aktin e Themelimit.

TRANSGLOBAL RENTALS SHPK është person juridik shqiptar që e fiton këtë të drejte në momentin e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit(QKB). Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet: **TRANSGLOBAL RENTALS SHPK**, Tirane.

Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë **TRANSGLOBAL RENTALS SHPK** është në Tiranë, në adresen : në Rruga Jordan Misja, Nd.170;H.29;Ap.34; Njesia Administrative Nr.9, 1016;Tiranë,

Neni 4 **Objekti i veprimtarise**

Shoqëria TRANSGLOBAL RENTALS SHPK zhvillon aktivitetin e meposhtem:
Tregti me shumice dhe pakice të të gjitha artikujve industrial e ushqimor. Ndertime dhe projektme godinash civile e ekonomike, rikonstruksion, germime dheu, taracime, ndërtim rruges, ndërtim vepra arti. Prodhim e tregtim te duraluminit, eksport - import. Tregtim dhe prodhim te mobiljeve, eksport - import. Hapja e serviseve per automjete te ndryshme. Transoprt i mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit. Hapje të aktiviteteve në fushen e turizmit. Agjensi mjetesh transporti te cdo lloji me qera, shitblerje te mjeteve te ndryshme. Agjensi Turistike, paketa turistike dhe çdo sherbim tjeter qe lidhet me kete aktivitet. Shitje bileta avioni dhe transport tjeter te çdo lloji. Pjesemarrje ne tendera te organizuar nga ente ose institucione shteterore apo private, prokurime publike. Si edhe cdo tjeter aktivitet qe ka te beje me fushen e transporteve brenda dhe jashte Shqiperise. Import, eksport dhe tregtimi me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise, apo te treteve te materialeve te ndertimit, produkteve ushqimore dhe industriale, makinerive, pajisjeve e pjese kembimi te tyre, lendeve te para, produkteve te gatshme e gjysem te gatshme, mineraleve. Transport kombetar e nderkombetar ne rruge detare, tokesore, apo ajrore; Riparimin e makinerive te ndertimit dhe mjeteve rrugore per nevojat e shoqerise dhe te treteve; Shoqëria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj sherbim apo aktiviteti ndertimi, tregtar, financiar, konsulence, qiradhenes apo dorezanes, qe i lejohet nje shoqerie sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te veprimtarise se saj.

Neni 5 **KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë e pacaktuar.

Neni 6

Të dhëna te tjera, adresa elektronike

Adresa e shoqërise për qellime komunikimi elektronik është si vijon :
Email : transglobal.rental@gmail.com

Neni 7

VLERA, KUOTAT DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

-Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në

shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë **TRANSGLOBAL RENTALS SHPK** është 100 leke, i ndarë në 1 pjese te kapitalit .

Kapitali është tërësisht kontribut i themeluesit të shoqërisë, Znj. Elisa Hoxhaj, perkatesisht:

1. Elisa Hoxhaj zotëruese 100 % , nje kuote me 100 leke.

Neni 8

LLOJET E KUOTAVE, TE DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat dhe kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblese se pergjithshme, të marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave te ortave, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

Neni 9

ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE

Ortaku ka të drejte te perfitoje nje çertifikate për kuotën e zotëruar prej tij.

Shoqëria nuk është e detyruar të leshoje me shumë se një certifikate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorzimi i certifikates ndaj perfaqsesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithë zoteruesve te kuotave ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit. Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes.

Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letres me vlere.

Neni 10

MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise,
 - b) Shitblerjes,
 - c) Trashegimise,
 - d) Dhurimit,
 - e) Cdo menyre tjeter te parashkuar me ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë

shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Neni 11

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
2. Shoqëria mund të vendosë zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 12

BLERJA E KUOTAVE TË VETA

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta e të kryej pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do të shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët leshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, padite mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 13

THIRRJA E ASMBLESE SË PËRGJITHSHME

- Administratorët therrasin Asamblenë e përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e të dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Secilit ortak se bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
- Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 14

MBLEDHJA E ASMBLESE SE PERGJITHSHME

- Asambleja e pergjitheshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumit te parashkuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaqseset e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen(konference call) , audio ose audio video ne perputhje me nenin 88 te Ligjit.Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimielektronik kane te drejte te votojne nepermjet numrit PIN qe iu eshte derguar se bashkume njoftimin per mbledhjen e Asamblese se pergjitheshme.
- Administratoret caktojne kryetarin e mbledhjes si edhe nje person per te mbajtur procesverbalin e saj.
- Nese asnje prej administratorevenuk deshiron te caktohet si kryetar i mbledhjes ose asnje prej administratoreve nuk eshte i pranishem per 15 minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.
- Administratori, pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se pergjitheshme.
- Kryetari, me pelqimin e Asamblese se pergjitheshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e pergjitheshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se pergjitheshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e mepareshme. Kur mbledhja e Asamblese se pergjitheshme shtyhet , njoftimi do ti dergohet gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se caktuar dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjesse shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme
- Asambleja vendos me votim te hapur me perjshtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga :
 1. Kryetari; ose
 2. nje ortak ose ortaket te cilet perfaqsojne te pakten 5 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqses i autorizuar i ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku.
- Me perjshtim te kundershimit te nje ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevojje per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.
- Ne rast se ka kundershime per kete deklarate, do te zhvillohet nje votim i fshehtene lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

Neni 15

VOTAT E ORTAKEVE

- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të këtij ligji

- Cdo kundërshtim në kohë për çelësin e një votuesi do të komunikohet kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.

Neni 16 VOTIMI ME PROKURË

-Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

-Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

- Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.”.

-Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme(ose në formën e zakonshme apo në formën që mund të miratohet nga administratorët) . . , përcaktuar në Statut.

Neni 17 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

-Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për :

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij,
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria,
- d) dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 18 HETIMET E POSACME, SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TË PARREGULLTA, DEMSHPERBLIMI

Personi ose personat që plotësojnë kushte për të kërkuar emerimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit praqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklaratë notoriale në selinë e shoqërisë , e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

-Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 87, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

-Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër,

brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt, përpara gjykatës kompetente, padi në emër të shoqërisë, për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.”

Neni 19

EMERIMI I ADMINISTRATOREVE

-Asambleja e përgjithshme emëron një ose me shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejtë ripërteritje.

Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundërvetohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 11 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

-Administratorët e një shoqërie tregtare merr, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

- Personi i meposhtëm caktohet si administrator i shoqërisë :

1. Elisa Hoxhaj , e bija e Muratit lindur në Zogaj, Tropojë me 01.09.1992, banues në Rruga Jordan Misja, Nd.170;H.29;Ap.34; Njesia Administrative Nr.9, 1016;Tiranë, madhore dhe me zotesi të plotë juridike,mbajtes i kartes se identitetit me nr. O36884962 dhe numur personal J25901038A.

- Administratori , Elisa Hoxhaj do të caktohet edhe si kryetar i mbledhjeve të administratorëve, deri në rast zgjedhjes së një tjetri me vendim të Asamblese së Ortakëve.

Neni 20

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të :

- a) Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e sakt të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
- e) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryen regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raporton përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në Ligj e në Statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e përgjithshme në rast kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë se ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blerë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

- Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

- Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

- Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji."

Neni 21 PERFAQESIMI

- Kufizimet e tagrave të perfaqësimit të administratoreve i kondrejtohen paleve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

- Administratorët, që perfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apër kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

- Tagrat e perfaqësimit të administratoreve dhe çdo ndryshim e tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 22 SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATOREVE

Detyra e administratorit perfundon në rast se :

1. personi nuk është me administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të ligjit "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

2. Personi ndodhet ne gjendje paaftesie pagueuse;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga crrregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjen e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe asambleja e pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 23

SHPERBLIMI, PERFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATOREVE

- Administratoret shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te Ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare"
- Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojë perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime dhe forma te tjera, per cdo person e cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre(perfshire bashkeshortin/en, ish bashkeshortin/en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre dhe mund te paguaj kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.
- Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesmarjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreveose te komiteteve te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

Neni 24

MBLEDHJET E ADMINISTRATOREVE

- Mbledhjet e Administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te shoqerise.
- Asambleja e Pergjithshme cakton njerin prej Administratoreve ne detyren e kryetarit te mbledhjes se administratoreve, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishem. Ne rast se kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda 5 minutave nga ora e caktuar per mbledhjen, Administratoret e pranishem mund te emerojne njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.
- Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesemarreve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e kryetarit do te jete vendimtare.
- Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratoreve, ose nga nje komitet i Administratoreve, apo nga persona te cilet veprojne si administratore, pavaresisht nese behet e ditur me vone se ka pasur mangesi ne emerimin e nje Administratori ose njeri prej tyre ka qene i skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin,

do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

-Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Administratoreve ose nga komiteti i i Administratoreve do te konsiderohet si i vlefshem dhe i efektshem njelloj sikur te ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 25

KUFIZIMET NE VOTIMET E ADMINISTRATOREVE

-Administratoret nuk duhet te lidhin marreveshje ose te votojne ne mbledhjen e Administratoreve, per ceshtje ne te cilin keta anetare kane , direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundërshtim me interesat e shoqerise,, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit 9901, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithë anetarët kane rënë dakort qe :

- te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe
- te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.

Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Autorizimi i pergjithshem duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

-Vota e Administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarrësve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk ka te drejte te votoje. Dispozitat e nenit 89 te Ligjit “per tregtarët dhe shoqerite tregtare” do te zbatohen lidhur me perjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra ne kete mbledhje.

-Ne rast se ne mbledhjen e Administratorët ose te komitetit te Administratorevediskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje Administratori , ceshtja duhet t’i drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me cdo Administrator te ndryshem nga ai vete do jete perfundimtar dhe i formes se prere.

Neni 26

PROCESVERBALET E MBLEDHJEVE TE ADMINISTRATOREVE

Administratoret kujdesen qe ne libra te posacem te mbahen procesverbalet e:

1. te gjitha takimeve te kryera nga Administratorët; dhe
2. te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, mbledhjeve Administratoreve dhe komiteteve te Administratoreve, perfshire edhe emrat e Administratoreve te pranishem ne keto mbledhje.

Neni 27

BILANCI

Pasuria e shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit sipas vleresimit të Asamblese se orttakeve në momentin e themelimit të shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars dhe hartohet në përputhje me Ligjin 25/2018, datë 29.4.2004 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare .

Neni 28 DIVIDENDET

-Pas plotesimit te parashikimeve te Neni 77 te ligjit nr.9901, shoqëria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga e drejta qe lidhen me kuotat , te gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumate e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi. Te gjithë dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumate e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi.; ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht..

Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqërisë nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

-Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 te Neni 77 te Ligjit , ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

- Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas neni 13, të këtij ligji, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.”.

- Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.”

Neni 29 KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e pergjithshme shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit , mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqërisë fitimet e pashperndara te cilat nuk\ do te perdoren per te paguar dividende prferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqërisë.

Neni 30 PRISHJA DHE LIKUJDIMI

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;

d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të Ligjit.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t’i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.” Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Regullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nënenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901; Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtezuar, në përputhje me nënenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 31 NJOFTIMET

-Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të këtij akt-themelimi apo Statutit duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

-Shoqëria mund të njoftojë një oratë personalisht ose duke e dërguar njoftimin me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që është njoftuar shoqërisë nga ortakët. Kur ka disa bashkëzotues të një kuota, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

Ky **akt-themelimi** së bashku me statutin, dhe dokumente të tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratoret në faqen

e internetit te shoqerie, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te Statutit (nese zbatohet) .

Neni 32

Per cdo pike qe nuk parashikohet ne kete AKT-THEMELIM do t'i referohemi Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe statutit.

Ky akt-themelimi hyn në fuqi menjëhere

ORTAKU I SHOQERISE TRANSGLOBAL RENTALS SHPK

ELISA HOXHAJ

Tiranë me date 05.10.2023

Elisa Hoxhaj
Hoxhaj